| | |
|---|---|
| Emertimi dhe Forma ligjore | Albania Distribution Chem |
| NIPT -i | L82203011N |
| Adresa e Selise | Rruga"Kavajes" |
| | Tirane |
| Data e krijimit | 28.09.2018 |
| Nr. i Regjistrit Tregetar | |
| Veprimtaria Kryesore | Tregeti te Produkteve Kimike |

# PASQYRAT FINANCIARE

( Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare )

# Viti 2020

| | | |
|---|---|---|
| Pasqyra Financiare jane individuale | | PO |
| Pasqyra Financiare jane te konsoliduara | | |
| Pasqyra Financiare jane te shprehura ne | | |
| Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne | | |
| Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare | Nga | 01.01.2020 |
| | Deri | 31.12.2020 |
| Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare | | 25.02.2021 |

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

# PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

| | Periudha 2020 | Periudha 2019 |
|---|---|---|
| **AKTIVET** | | |
| **Aktive afatshkurtra** | | |
| ***Mjete monetare*** | 1,413,108 | 1,252,839 |
| ***Te drejta te arketueshme dhe te tjera investime financiare*** | | |
| Kerkesa te arketueshme afatshkurtra | 1,836,075 | 1,441,282 |
| Te tjera te arketueshme | 99,489 | 16,090 |
| Instrumenta te tjera financiare | | |
| *Te tjera aktive afatshkurtra (pershkruaj)* | | |
| **Shuma** | 1,935,564 | 1,457,372 |
| ***Inventare*** | | |
| Lende te para dhe materiale te konsumueshme | | |
| Prodhim ne proces dhe gjysem produkte | | |
| Produkte te gatshme | | |
| Mallra per shitje | 4,200,773 | 3,343,413 |
| Parapagesa per inventare | 3,417,045 | 2,959,137 |
| **Shuma** | 7,617,818 | 6,302,550 |
| **Shuma aktive afatshkurtra** | 10,966,490 | 9,012,760 |
| **Aktive afatgjata** | | |
| ***Aktive afatgjata financiare*** | | |
| Depozita afatgjata, huadhenie dhe te tjera te ngjashme | | |
| Deftesa te arketueshme dhe kliente afatgjate | | |
| **Shuma** | | |
| ***Aktive afatgjata materiale*** | | |
| Toka dhe ndertesa | | |
| Makineri dhe paisje | | |
| Te tjera ne shfrytezim | 109,465 | 136,831 |
| **Shuma** | 109,465 | 136,831 |
| ***Aktive afatgjata jomateriale*** | | |
| *Te tjera aktive afatgjata (pershkruaj)* | | |
| **Shuma aktive afatgjata** | 109,465 | 136,831 |
| **TOTALI AKTIVEVE** | 11,075,955 | 9,149,592 |

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

## DETYRIMET DHE KAPITALI

| | | |
|---|---|---|
| ***Detyrime afatshkurtra*** | | |
| Tituj te huamarrjes afatshkurter | | |
| Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit | 2,190,528 | 1,298,256 |
| Te pagueshme ndaj punonjesve, kontribute dhe te tjera te ngjashme | 816,354 | 386,028 |
| Te pagueshme per detyrime tatimore | 741,049 | 472,111 |
| Parapagimet e arketuara | 6,575 | |
| *Te tjera detyrime afatshkurtra (Ortaku)* | 2,771,232 | 4,700,000 |
| **Shuma** | 6,525,738 | 6,856,394 |
| | | |
| ***Detyrime afatgjata*** | | |
| Tituj te huamarrjes agatgjate | | |
| *Te tjera detyrime afatgjata (pershkruaj)* | | |
| **Shuma** | | 0 |
| | | |
| **Shuma e detyrimeve** | 6,525,738 | 6,856,394 |
| | | |
| ***Kapitali*** | | |
| Kapitali i pronarit | 2,100,000 | 100,000 |
| Rezerva (ligjore, statutore, etj) | | |
| Fitime/(Humbje) te periudhes financiare | 2,257,019 | 1,111,991 |
| Fitime/(Humbje) te mbartura | 193,198 | 1,081,206 |
| Terheqjet e pronarit | | |
| **Shuma e Kapitalit** | 4,550,217 | 2,293,198 |
| | | |
| **TOTALI DETYRIMET DHE KAPITALI** | 11,075,955 | 9,149,592 |
| | 0 | 0 |

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

## PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

***(sipas natyres) - e detyrueshme***

| | Periudha 2020 | Periudha 2019 |
|---|---|---|
| Shitjet neto | | |
| Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | 26,494,175 | 8,637,833 |
| Ndryshimet ne inventarin e produkteve te gateshme dhe punes ne pr | 0 | 37,800 |
| Puna e kryer nga njesia ekonomike raportuese per qellimet e veta dh | 0 | |
| Mallrat, lendet e para dhe sherbimet | - 21,589,157 | - 6,821,644 |
| Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | | |
| Shpenzime te personelit | - 728,208 | - 231,066 |
| Pagat | - 624,000 | - 198,000 |
| Shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore | - 104,208 | - 33,066 |
| Amortizimi | - 27,366 | - 12,244 |
| Shpenzime te tjera | - 1,378,952 | - 256,467 |
| **Fitimi/(humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit** | 2,770,492 | 1,354,212 |
| | | |
| ***Te ardhura e shpenzime financiare*** | | |
| Te ardhurat/(shpenzimet) nga interesi | | - 45,526 |
| Fitime/(humbje) nga kurset e kembimit | -112792.91 | |
| Te tjera te ardhura/(shpenzime) financiare | | |
| **Shuma** | -112,793 | -45,526 |
| | | |
| **Fitimi/(humbja) para tatimit** | 2,657,699 | 1,308,686 |
| Shpenzimet e tatimit mbi fitimin | - 400,680 | - 196,695 |
| **Fitimi/(humbja) neto e periudhes financiare** | 2,257,019 | 1,111,991 |

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

## Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (o

***Metoda indirekte***

| | Periudha 2020 | Periudha 2019 |
|---|---|---|
| **Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:** | | |
| Fitimi/(Humbja) perpara tatimit | 2,657,699 | 1,308,686.4 |
| *Rregullime per :* | | |
| Shpenzime amortizimi | 27366.2 | 12,243.8 |
| Humbje/(Fitime) nga konvertimi | | - |
| Shpenzimet financiare te perllogaritura | | |
| Te ardhura nga investimet | | |
| Humbja/(Fitimi) nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | |
| Te tjera *(pershkruaj)* | | |
| Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit | | |
| Renie/(Rritje) ne kerkesat e arketueshme nga aktiviteti dhe kerkesa te tjera | -478,192 | 496,413.5 |
| Renie/(Rritje) ne gjendjen e inventarit | -1,315,269 - | 3,203,239.6 |
| Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme | -330,656 | 1,258,152.4 |
| Interes i paguar | | |
| Tatim fitimi i paguar | -400680 - | 196,694.9 |
| **Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit** | **160,268.5 -** | **324,438.5** |
| **Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit** | | |
| Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale | 0 | -85100 |
| Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | |
| Interes i arketuar | | |
| Dividente te arketuar | | |
| Te tjera *(pershkruaj)* | | |
| **Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit** | **0** | **-85100** |
| **Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit** | | |
| Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar | | |
| Hua te arketuara | | |
| Pagesa e huave | | 500000 |
| Pagese e detyrimeve te qirase financiare | | |
| Dividende te paguar | | |
| Te tjera *(pershkruaj)* | | |
| **financimit** | **0** | **500000** |
| **me to** | **160,269** | **90,462** |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim | 1,252,839 | 1,162,377 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund** | **1,413,107** | **1,252,839** |
| | 0 | 0 |

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

**Tregtari "ALBANIA DISTRIBUTION CHEM"** (Shpk), në vijim e quajtur "Njësia ekonomike" ose shkurt "Njësia", është regjistruar në QKB më datë 03/10/2018.

**Emri tregtar** i tij është " **ALBANIA DISTRIBUTION CHEM** "

**Përfaqësuesi ligjor** është personi i vetpunësuar Z. Julian Memelli.

Njësia është e regjistruar si Shpk në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT L82203011N

**Selia e njësisë** është: RRUGA Rruga e Kavajes, Buka Sha, nr pasurie 8240 ,Njesia nr 6 Tiranë

**Objekti kryesor i veprimtarisë është:** Tregti me shumice dhe pakicë të artikujve te ndryshem kimike. Importe. Etj.

Gjatë vitit 2020 njësia ka ushtruar aktivitetin në përputhje me objektin e saj.

**Ligji 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", parashikon dy paketa të rregullimit kontabël:**

a) Standadet Kombëtare të kontabilitetit (te njohura si SKK);

b) Standardet Ndërkombëtare të raportimit Financiar ( të njohura si SNRF);

Këto standarde zbatohen për të gjitha njësitë ekonomike pavarësisht formës së tyre ligjore, me apo pa qëllim fitimi, publike apo private etj.

Sipas këtij ligji mikronjësitë, njësitë ekonomike të Vogla e të Mesme duhet të zbatojnë SKK-të për ndërtimin e pasqyrave financiare. Ai përcakton gjithashtu kriteret e klasifikimit në këto grupe.

Ky ligj ndër të tjera përcakton:

**Mikronjësi ekonomike** janë të gjitha ato njësi ekonomike të cilat në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën 2 prej 3 kritereve të mëposhtme:

a)aktivi,15 mil lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 30 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 10.

**Njësi ekonomike të vogla** - njësitë ekonomike, jo mikro, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme:

a)aktivi, 150 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 300 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 50.

**Njësi ekonomike të mesme** - njësitë ekonomike, jo mikro dhe jo të vogla, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme:

a) aktivi, 750 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 1 500 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 250.

**Njësi ekonomike të mëdha** - njësitë ekonomike, që në datën e raportimit tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme:

a) aktivi, 750 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 1 500 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 250.

Albania Distribution Chem
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

**Njësia "ALBANIA DISTRIBUTION CHEM" PF, klasifikohet sipas këtyre kritereve si mikronjësi**

Këto shënime shpjeguese do të strukturohen sipas renditjes së mëposhtme
(1) **kuadrin kontabël të aplikuar**
(2) përshkrimin e **politikave kryesore kontabël,** të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare;
(3) **informacion-shtesë mbi zërat materialë**, të paraqitur në pasqyrat parësore dhe ndryshimet e tyre gjatë periudhës kontabël (pasqyrat parësore do të përmbajnë referenca që të drejtojnë në shënimet e bashkëngjitura, të cilat shpjegojnë më hollësisht informacionin e paraqitur në pasqyrat parësore);
(4) **informacion tjetër të nevojshëm** për një paraqitje të vërtetë e të besueshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese (për shembull, pasivet e mundshme, transaksionet me palët e lidhura, ngjarjet që kanë ndodhur pas datës së bilancit).

Sipas strukturës së mësipërme,vijojnë më poshtë shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të tregtarit "Albania Distribution Chem" TR.

## 1. KUADRI KONTABËL PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE

### (a) Baza e përgatitjes

Bazuar në ligjin 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe SKK15 "Mbi parimet e kontabilitetit dhe raportimeve financiare për mikronjësitë", i përmirësuar i zbatueshëm nga viti 2017 e në vijim si dhe i ndryshuar, i zbatueshëm nga viti 2019, njësia ekonomike duhet dhe ndërton pasqyrat financiare për vitin 2020 sipas kësaj SKK-je.
Ky standart zbatohet në mënyrë prospektive nga data 01 Janar 2019, tani e në vijim e quajtur SKK15-ta.

Megjithatë njësia ka riparaqitur pasqyrat fiannciare të vitit paraardhës sipas këtij standardi, të ndryshuar. Atje ku ka çështje që nuk mbulohen nga SKK15, njësia i referohet standardit përkatës të 14 SKK-ve të publikuara nga KKK-ja.

Drejtimi i njësisë vlerëson se do të vijojë aktivitetin normal tregtar për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave fiannciare. Si rrjedhim këto pasqyra janë përgatitur **mbi bazën e parimit të vijimësisë.**

### (b) Bazat e matjes

Dy bazat e zakonshme të matjes janë kosto historike dhe vlera e drejtë. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të mëposhtme. Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri, pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuar. Mbajtja e kontabilitetit përfshin regjistrimet kontabël dhe sistemin e tij të kontabilitetit. Regjistrimet mbahen në mënyrë të kompjuterizuar me anë të një programi të kontabilitetit.



Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

**(c) Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë ekonomike dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

**(d) Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Monedha funksionale e shoqerise eshte LEKE dhe pasqyrat financiare paraqiten në lek dhe nuk janë të rrumbullakosura.

## 2. POLITIKAT KONTABËL KRYESORE

Politikat kontabël kryesore që janë përdorur për të përgatitur këto pasqyra financiare janë si vijon:

### 2.1 AKTIVET FINANCIARE

Aktivet financiare janë:

-para ose ndryshe Mjete Monetare (MM);

- të drejta kontraktuale për të marrë para ose një aktiv tjetër financiar të cilat njësia i klasifikon në:

- llogari të arkëtueshme nga klientët;

-kërkesa të tjera të arkëtueshme;

Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes së tyre.

- **Mjetet monetare (MM) dhe ekuivalentët e tyre** përfshijnë MM në arkë si dhe ato të mbajtuar në banka. Ato vlerësohen me vlerën nominale e cila përfaqëson koston historike si dhe në këtë rast kosto historike është e barabartë me vlerën e drejtë të tyre.

**Overdraftet bankare** konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga MM-të dhe ekuivalentët e MM-ve

**llogaritë e arkëtueshme tregtare (klientët)** njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe si rrjedhim ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët ose kur njësia ekonomike lëshon faturën për shërbin e kryer ose mallrat e shitur. Njohja fillestare e kërkesave për tu arkëtuar nga klientët ndodh kur shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer.

**Për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme përdoret metoda e kostos.**

**Në hyrje ato vlerësohen me vlerën e drejtë** e cila është vlera e aktuale e arkëtimeve të ardhshme të skontuar me normën e interesit të tregut për instrumenta të ngjashëm. Meqënëse të gjithë klientët janë afatshkurtër ato vlerësohen me shumën e paskontuar.

**Në bilanc ato paraqiten me koston e amortizuar**(kosto fillestare minus shlyerjet(arkëtimet e bëra) minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka).



Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajes, Tirane, Albania

Një zhvlerëim për rënie në vlerë të të drejtave për tu arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që njësia nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies në vlerë të llogarive të arkëtueshme kur:
-debitori ndodhet në vështirësi financiare;
-debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar;
Mos arkëtimi ose vonesa në arkëtim çon në vlerësimin e mundësisë së arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një llogari vlerësohet si e paarkëtueshme ajo regjistrohet si shpenzim dhe në llogarinë e zhvlerësimit deri sa të konfirmohet përfunimisht mosarkëtimi i saj, momemnt në të cilin bëhet dhe çrregjistrimi final e llogarisë së arkëtueshme.
Nëse më pas arkëtohen shuma të cilat janë çrregjistruar atëherë kreditohen shpenzimet për këto shuma.
**-Kërkesat e tjera të arkëtueshme** njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Ato vlerësohen në hyrje dhe në bilanc po ashtu si dhe llogaritë e arkëtueshme nga klientët
-Nga analiza e kërkesave të tjera të arkëtueshme nuk rezultuan zhvlerësime.

## 2.2 DETYRIMET FINANCIARE

Njësia i klasifikon detyrimet financiare në afatshkurtra dhe afatgjata
Ato sipas përmbajtjes së tyre klasifikohen në:
-detyrime tregtare ose ndryshe quhen Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve;
-detyrime të tjera;
-huamarrje

- **Llogaritë e pagueshme tregtare ndaj furnitorëve** njihen si detyrime kur njësia ekonomike bëhet palë në një kontratë dhe si rrjedhim ka detyrim ligjor për të dhënë mjetë monetare ose një tjetër aktiv furnitorit ose kur njësia ekonomike ka marrë faturën për shërbimin e marrë ose të mirat materiale të blera. Njohja fillestare e detyrimit tregtar ndaj furnitorit bëhet kur shërbimi është nisur, ka mbërritur ose është kryer.

  **Për vlerësimin e detyrimeve tregtare përdoret metoda e kostos**
  **Në hyrje ato vlerësohen me koston e transkasionit (vlera e drejtë)** e cila është vlera e aktuale e pagesave të ardhshme të skontuar me normën e interesit të tregut për instrumenta të ngjashëm. Meqënëse të gjithë furnitorët janë afatshkurtër ato vlerësohen me shumën e paskontuar që njësia i detyrohet furnizuesit (pagesa e pritshme) dhe që është zakonisht vlera e faturës.
  **Në bilanc ato paraqiten me koston e amortizuar** (kosto fillestare minus shlyerjet)

**Detyrime të tjera (pa kushte tregtare)** përdoret metoda e kostos historike. Ato vlerësohen me shumën e paskontuar minus arkëtimet / shlyerjet e tyre minus zhvlerësimin.

**-Huamarrjet afatshkurtra vlerësohen me kosto** (pa përfshirë kostot e transaksionit) dhe paraqiten në bilanc me koston e amortizuar



Albania Distribution Chem
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

**-Huamarrjet afatgjata njihen fillimisht me kostot e transaksionit** ( duke përfshirë dhe tarifat shtesë) e cila është vlera aktuale e pagesave të pritshme të ardhshme të skontuara me një normë interesi dhe paraqiten në bilanc me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo diferencë mes vlerës në njohje dhe vlerës në maturim njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv.

## 2.3 TRANSAKSIONET NË MONEDHA TË HUAJA

Transaksionet në monedhë të huaj përgjithësisht konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Gjatë periudhës janë përdorur kurse këmbimi ditore ose dhe mesatare javore kur nuk ka patur luhatje të konsiderueshme (sic e lejon SKK12 pika 12).
Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat e konvertimit, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "të tjera të ardhura/shpenzime financiare" në përputhje me SKK 12 (pika 15).
Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 dhjetor janë si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| EURO | 123.7 | 121.77 |
| USD | 100.84 | 108.64 |

## 2.4 INVENTARËT

Inventarët njihen në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 15, kur njësia i kontrollon ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to dhe kur kosto matet në mënyrë të besueshme.
**Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve** vlerësohen me koston e tyre që përfshin çmimin e blerjes dhe gjithë shpenzimet e tjera që nevojiten për sjelljen e tyre në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese.
**Inventarët në fund** vlerësohen me vlerën më të ulët mes kostos historike të blerjes / prodhimit dhe vlerës së pritshme të shitjes minus kostot e përfundimit të prodhimit të produkteve dhe të realizimit të shitjes.

Në të gjitha rastet kostoja historike e blerjes/prodhimit ka rezultuar më e vogla dhe pikërisht ajo është përdorur për të vlerësuar inventarin.

## 2.5 AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

**Për vlerësimin e AAM-ve** përdoret metoda e kostos historike.
**Në hyrje AAM-të vlerësohen me koston e tyre** e cila përbëhet nga kosto e blerjes e cila përfshin çmimin dhe shpenzimet e tjera si taksa importi etj si dhe çdo shpenzim tjetër që kryhet për të sjellë aktivin në në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionim.
Ato vlerësohen me koston historike të amortizuar minus zhvlerësimin dhe raportohen me vlerën neto të mbetur.

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

Për këto aktive është bërë testi i zhvlerësimit në fund të vitit dhe ka rezultuar se nuk ka ndryshime domethënëse ne vlerë.

### 2.5 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimevë njihen kur ekziston një marrëveshje me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer si dhe rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së mallit apo shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitime që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar , arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen.

Njësia ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturauar apo paguar ato.

## III INFORMACION SHTESË MBI ZËRAT MATREIAL

Më poshtë paraqiten informacione shtesë mbi zërat materialë të pasqyrave financiare kryesore sipas numrave referencë që mund të gjenden në këto pasqyra.

## Për Pasqyrën e Pozicionit Financiar

### 1. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit 1,413,108

| 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|
| 1,836,075 | 1,441,282 |

Vlera prej 1,836,075 lekë përfaqëson vlerën e klientëve ende të palikujduar më 31/12/2020

Kemi një rritje të llogarive të arkëtueshme tregtare (klientë) nga 1,441,282 lekë në 1,836,075 lekë .

### 2. Të tjera të arkëtueshme 99,489

**Ky zë përbëhet nga:**

| | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Tatim Fitimi | 47,232 | 0 |
| Parapagim Dogana | 52,257 | 16,090 |

Vlera prej 47,232 lekë përfaqëson tepricën e Tatim Fitimit e cila është një tepricë e debitore (e zbritshme).

Vlera prej 52,257 përfaqëson parapagimet e bëra në doganë për qëllime të zhdoganimit të mallrave të importuara të cilat janë objekt i detyrimeve doganore

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

## 3. Mallra 8,367,685

| 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|
| 4,200,773 | 3,343,413 |
| 3,417,045 | 2,959,137 |

Përfaqëson vlerën e mallrave gjendje më 31.12.2020 me shumën 4,200,773 dhe te mbipagesave ndaj furnitorëve per mallra të ardhura gjatë 2021 me vlerë 3,417,045 leke

## 4. Aktivet afatgjata materiale 27,314

| 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|
| 109,465 | 136,831 |

Vlera prej 109,465 lekë përfaqëson vlerën kontabël neto (vlera e mbetur) e AAM-ve te njësisë të cilat janë mobilje zyre.

| | |
|---|---|
| Kosto historike | 149,075 |
| Amortizim i akumuluar | 39,610 |
| Vlera Kontabël Neto | 109,465 |

| Gjendje me 31 dhjetor 2019 | | | Shtesa | Pakesi me | Gjendje me 31/12/2020 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Kosto historike* | Amortizim i Akumuluar | *Vl Mbetur* | *vlefta* | *vlefta* | Kosto historike | Amortizim i 2020 | Amortizimi i Akumuluar | Vl mbetur 31.12.2020 |
| 149,070 | 12,244 | 136,826 | 0 | 0 | 149,070 | 27,366 | 39,610 | 109,465 |

- Amortizimi i llogaritur për vitin 2020 është 27,366 lekë

| | |
|---|---|
| Metoda e amortizimit | Lineare mbi vlerën e mbetur |
| Norma e amortizimit | 20% Paijse e mobilje zyre |

## 5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit 7,664,852

| Viti 2020 | Viti 2019 |
|---|---|
| 2,190,528 | 1,298,256 |

Vlera prej 2,190,528 lekë përfaqëson vlerën e furnitorëve gjendje më 31/12/2020 ende të palikujduar, për blerje të ndryshme në funksion të aktivitetit të shfrytëzimit.

## 6. Të pagueshme per detyrimet Tatimore 741,049

Ky zë përbëhet nga:

| | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Detyrime TVSH | 741,049 | 246,789 |
| Detyrime Tatim Fitimi | 0 | 220,922 |

Albania Distribution Chem
NUIS: L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

Këto zëra paraqesin detyrimin e njësisë për TVSH-së, detyrime të cilat i përkasin muajit dhjetor 2020 dhe janë shlyer në muajin Janar 2021.

**7. Të pagueshme ndaj punonjësve, kontribute dhe të tjera të ngjashme** **816,354**

Ky zë përbëhet nga:

| | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Detyrime Paga | 796,640 | 373,568 |
| Detyrime sigurime | 19,714 | 12,460 |

Këto zëra paraqesin detyrimin e njësisë për paga ndaj punonjesve dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, detyrime të cilat i përkasin muajit dhjetor 2020 dhe janë shlyer në muajin Janar 2021.

## Për Pasqyrën e Performancës

**8. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit** **26,494,175 lekë**

| Viti 2020 | Viti 2019 |
|---|---|
| 26,494,176 | 8,675,633 |

Vlera prej 26,494,176 përfaqson të ardhurat nga aktiviteti kryesor i saj i cili është shitja e artikujve te ndryshme kimike.

**9. Mallrat Lëndët e para dhe shërbimet** **(21,589,157)**

| Viti 2020 | Viti 2019 |
|---|---|
| (21,589,157) | (6,821,644) |

Në këtë zë janë përfshirë kosto e mallrave të shitura . Për vlerësimin e kostos së mallit të shitur është përdorur metoda e kostos mesatare. Kosto përfshin cmimin e blerjes si dhe shpenzimet e tjera të kryera për të sjellë mallin në gjendjen dhe vendndodhjen egzistuese.

**10. Shpenzime të tjera për veprimtaritë e shfrytëzimit** **(1,378,952)**

| Viti 2020 | Viti 2019 |
|---|---|
| (1,378,952) | (256,467) |

Në këtë zë janë përfshirë shpenzime të tilla si energji, qira ambjenti, mirembajtje dhe riparime, sherbima bankare, blerje te tjera te pastokueshme, taksa dhe tarifa vendore etj

Albania Distribution Chem
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

**11. Shpenzime personeli** **(728,208)**

**Ky zë përbëhet nga:**

| | **31 Dhjetor 2020** | **31 Dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Shpenzime paga | 624,000 | 198,000 |
| Shpenzime sigurime | 104,208 | 33,066 |

Këto zëra përfaqësojnë shpenzimet për paga për periudhën ushtrimore 2020 si dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore & shëndetsore të lidhura me këto paga.

**12. Fitim humbjet nga kurset e këmbimit** **(112,793)**

Fitim humbjet nga kurset e këmbimit janë paraqitur me vlerën neto të tyre.
Ky zë përbëhet si më poshtë :

| | **31 Dhjetor 2020** | **31 Dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Fitim nga KK | 0 | 0 |
| Humbje nga KK | (112,793) | 0 |

**13. Shpenzime tatim fitimi** **0**

| **Viti 2020** | **Viti 2019** |
|---|---|
| 400,680 | 196,695 |

Njësia ka realizuar një xhiro mbi 14 mil dhe për këtë qëllim është subjekt i llogaritjes së tatimit mbi fitimin për fashën mbi 14 mil me normë 15%

**14. Perllogaritja e fitimit fiskal (fitimi i tatueshëm) per vitin 2020 është si më poshtë:**

| **Pershkrim** | **Shuma (leke)** |
|---|---|
| **Fitimi +/- Humbja ekonomike** | **2,657,699** |
| **Shpenzime te panjohura** | **13,501** |
| **Humbja fiskale e mbartur** | **0** |
| **Fitimi i tatueshëm** | **2,671,200** |
| **Tatim fitimi (15%)** | **-400,680** |
| **Fitimi +/ - Humbja Neto** | **2,257,019** |

d) **informacion tjetër të nevojshëm:** Nuk ka informacion tjetër të nevojshëm në lidhje me pasivet & aktivet e kushtëzuar apo ngjarje të ndodhura pas datës së pasqyrave financiare.

PËRFAQËSUESI I SUBJEKTIT
ALBANIA DISTRIBUTION CHEM

Albania Distribution Chem
NUIS L82203011N
Rr. Kavajës, Tiranë, Albania

Julian Memelli

Adresa: Rruga e Kavajes, Buka Sha, nr pasurie 8240 ,Njesia nr 6